



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.04.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4646/15, për zyrtarin e lartë z. Mustaf Gashi u.d. Drejtor i Departamentit Operativ në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-4646/15, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Mustaf Gashi u.d. Drejtor i Departamentit Operativ në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë z. Mustaf Gashi u.d. Drejtor i Departamentit Operativ në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave figuron si pronar dhe person i autorizuar në një biznes privatë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 22.02.2016 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Mustaf Gashi, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është interesuar për një takim me zyrtarët e AKK-së, për tu njoftuar me gjerësisht për situatën të cilën e ka iniciuar AKK-ë .

Në takimin e organizuar në zyrat e AKK-së me zyrtarin e lartë z. Mustaf Gashi, zyrtarët e AKK-së, e kanë njoftuar zyrtarin e lartë me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin e iniciuar për situatë të konfliktit të interesit.

z. Mustaf Gashi, është pajtuar me gjendjen, por është arsyetuar se biznesi në fjalë nuk zhvillon aktivitet dhe nuk ka qenë i informuar se kjo situatë është në kundërshtim me ligjin në fuqi, por është zotuar se brenda afatit ligjor do të bëjë ndryshimet dhe do të veprojë sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e konfliktit të interesit.

Me datën 22.04.2016, nga z. Gashi, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z. Mustaf Gashi, nuk figuron me si person i autorizuar në biznesin privat me emër N.SH “Konsulta Plus” me nr.70232111.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Mustaf Gashi u.d. Drejtor i Departamentit Operativ në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, duke bërë ndryshimet e parapara me ligj, duke u larguar nga personi i autorizuar në biznesin privatë janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

